



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



## MATERIAL INFORMUES

# LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

*Version në gjuhë të thjeshtuar*





Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij materiali për qëllime përfitimi!

Ky material u përgatit nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në kuadër të zbatimit të projektit “Qasje të barabartë për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në partneritet me organizatat Down Syndrome Albania dhe ANAD (Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë). Dokumenti informues është përshtatur në format të thjeshtuar dhe në gjuhë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me:

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rruga “Bogdaneve”, Nr.19, Tiranë

Tel: +35542269426

E-mail: [info@adrf.al](mailto:info@adrf.al)

web: [www.adrf.al](http://www.adrf.al)



Mendimet e shprehura në këtë dokument u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



# LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

## MATERIAL INFORMUES

Version në gjuhë të thjeshtuar.

Ky dokument është një version i thjeshtuar

për të garantuar që informacioni të jetë i lehtë për t'u kuptuar.



# ÇFARË KA NË KËTË GUIDË?

|                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Hyrje.....                                                                 | 1  |
| 2. Çfarë parashikon Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti? ..... | 2  |
| 3. Kush përfiton ndihmë juridike falas? .....                                 | 10 |
| 4. Si mund të merrni ndihmë juridike parësore? .....                          | 14 |
| 5. Si mund të merrni ndihmë juridike dytësore? .....                          | 17 |
| 6. Lista e dokumentave që duhet të dorëzoni .....                             | 19 |
| 7. Ku mund të merrni më shumë informacion? .....                              | 21 |

# 1. HYRJE



**Kjo guidë përmban  
informacion për  
ndihmën juridike falas  
të garantuar  
nga shteti.**



**Informacioni  
është përshtatur  
për t'u kuptuar më mirë  
nga persona me  
aftësi të kufizuara.**

## 2. ÇFARË PARASHIKON LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI?

Ligji për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti Nr. 111/2017, ofron shërbime ligjore falas për grupe në rrezik përjashtimi.

**1**

Grupet në rrezik përjashtimi janë ata grupe që nuk trajtohen njësoj me të tjerët ose mund t'ju shkelen të drejtat. **Personat me aftësi të kufizuara janë grup në rrezik përjashtimi.**

**2**

**Ligji siguron ndihmë juridike falas për personat me aftësi të kufizuar dhe persona të tjerë që nuk kanë para për të paguar.**

Nëse plotësoni kushtet, ju keni të drejtë të përfitoni ndihmë juridike falas për problemet tuaja civile, penale ose administrative.

## DISA SHEMBUJ TË PROBLEMEVE


Mund të keni probleme me  
**Komisionet e Vlerësimit të**  
**Aftësisë së Kufizuar.**



Mund të hasni probleme  
me marrjen e **pagesave.**



Mund të keni probleme me  
marrjen e **pensionit të**  
invaliditetit ose të pleqërisë  
dhe me ndihmën ekonomike.



Mund t'ju ushtrojnë  
dhunë në familje.



Mund të keni ankesa për  
shërbimet që keni  
marrë.



Mund të jeni hequr në  
mënyrë të padrejtë nga  
puna.



Mund të jeni **trajtuar keq**  
nga punëdhënësi.



Mund të jeni **trajtuar keq** në  
shkollën ku shkoni.



Mund të keni probleme me  
shtëpinë ku jetoni.



## JU MUND TË PËRFITONI NDIHMË JURIDIKE FALAS PËR ÇDO PROBLEM QË KENI.

Edhe nëse ke bërë diçka që shkel ligjin dhe ndodhesh në polici apo në paraburgim, ke të drejtë të marrësh ndihmë falas nga një avokat.




Ju mund të merrni **këshilla** dhe informacione të ndryshme nga një jurist apo një avokat, pa paguar.

**Avokati** është një person që njeh ligjet. Shteti do të paguajë avokatin për t'ju ndihmuar sipas ligjit.



Kur problemi që keni zgjidhet vetëm në gjykatë ose prokurori, ju duhet një avokat.

Avokati është një person që njeh ligjet dhe është aty **për t'ju mbrojtur**. Kjo ndihmë quhet ndihmë juridike dytësore.



Kur merrni këtë ndihmë, ju nuk paguani për avokatin, nuk paguani për shpenzimet për gjykatën.

Kjo do të thotë që ju nuk paguani nese keni nevojë **për psikologë**.

Psikologu është dikush që ju dëgjon dhe ju ndihmon për problemin që keni.



Ju nuk paguani edhe nëse duhet të përktheni dokumenta në gjuhë tjetër.



Nëse problemi që ke mund të zgjidhet pa shkuar në gjykatë, ti mund të marrësh ndihmë nga një jurist. Juristi të tregon çfarë mund të bësh për ta zgjidhur problemin pa gjyq. Kjo quhet ndihmë juridike parësore.

---



Juristët mund t'ju ndihmojnë nëse keni nevojë për informacion për të **drejtat dhe detyrimet që ju keni.**

Juristët mund t'ju ndihmojnë duke ju treguar se ku duhet të **shkoni** dhe çfarë duhet të bëni.

Juristët mund t'ju ndihmojnë për të shkruar një **letër** ose një **kërkesë**.



## NDIHMA JURIDIKE ËSHTË FALAS NËSE PLOTËSONI KUSHTET.

Kur paraqiteni për të kërkuar ndihmë juridike është mirë që të keni me vete një **dokument identifikimi**, si për shembull një **kartë identiteti** ose një **pasaportë**.



Ju duhet të paraqisni informacion të plotë dhe të vërtetë.

Ju duhet të dorëzoni disa dokumente shtesë kur kërkon ndihmë ligjore pa pagesë.

Dokumentet që duhet të dorëzoni i gjeni në fund të këtij udhëzuesi.



### 3. KUSH PËRFITON NDIHMË JURIDIKE FALAS?

**Sipas ligjit, personat që përfitojnë ndihmë juridike falas janë:**

- Persona me aftësi të kufizuara.



- Viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit.



- Fëmijët.



- Fëmijë që nuk jetojnë pranë familjeve të tyre, por në institucione rezidenciale.



- Persona me çrregullime psikologjike dhe sociale.



- Persona që pëfitojnë nga skema e mbrojtjes sociale, si ndihma ekonomike.



- Persona të diskriminuar.

**Persona të diskriminuar** janë ata persona që nuk trajtohen njësoj si të tjerët ose që ju shkelen të drejtat.



**Këta persona përfitojnë ndihmën juridike edhe kur nuk kanë para.**

## Persona të cilët nuk kanë para dhe pasuri të mjaftueshme sipas ligjit.

Këta persona mund të mos jenë pjesë e grupeve të mësipërme, por ata nuk kanë para ose prona për të paguar. Edhe këta persona mund të përfitojnë nga ndihma juridike falas.



Nëse për shembull, jetoni në një familje që ka pesë persona, nëna, babai, vëllai dhe dy motra. Nëse të ardhurat tuaja janë më pak se 20,000 lekë të reja për person në muaj, mund të përfitoni ndihmë juridike falas.



Nëse jetoni vetëm dhe merrni më pak se 40,000 lekë të reja në muaj, mund të përfitoni ndihmë juridike falas.




Që të marrësh ndihmë falas, nuk duhet të kesh shumë para ose pasuri. Mund të kesh vetëm shtëpinë ku jeton me familjen por ajo nuk duhet të jetë e shtrenjtë.



## 4. SI MUND TË MERRNI NDIHMË LIGJORE PARËSORE?

Ju mund të kërkonit ndihmë juridike parësore në vendet e mëposhtme, të cilat **nuk** përfshijnë gjykatat:

- Ju mund të kërkonit ndihmë juridike falas në një qendër shërbimi të ndihmës juridike parësore.
- Ju mund të kërkonit ndihmë juridike falas në Organizatat Jo-fitimprurëse.
- Ju mund të drejtoheni në Universitete, ku ka zyra ose klinika ligjore.
- Këto qendra dhe organizata ndodhen në qytete të ndryshme në Shqipëri.



Ju mund të merrni ndihmë **juridike** edhe në internet në faqen: [www.juristionline.al](http://www.juristionline.al)

Mund të merrni me shume **informacion** ne faqen: [www.ndihmajuridike.gov.al](http://www.ndihmajuridike.gov.al)

Mund të telefononi pa pagesë në numrin: **08001010**

Nëse përdorni **Facebook** mund të kërkon: **Drejtoria e Ndihmës Juridike**

Nëse përdorni **Instagram** mund të kërkon:  
**@DrejtoriaNdhmesJuridikeFalas**



Kur shkoni në qendra ose organizata, ju duhet të bëni një deklaratë që jeni person me aftësi të kufizuar.



Ju duhet të jepni edhe disa dokumenta të tjera, për shembull vërtetimin që jeni me aftësi të kufizuar. Qendra ose Organizata ku do të shkoni do t'ju tregojë dokumentet që ju nevojiten.



## 5. SI MUND TË MERRNI NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE?

Kur keni nevojë që të shkoni në gjykatë ose në prokurori, mund të merrni një avokat falas. Për të marrë avokat falas, ju duhet të dërgoni një kërkesë në gjykatë.



Zyrat e ndihmës juridike parësore, organizatat jo-fitimprurëse dhe klinikat e ligjit mund t'ju ndihmojnë të përgatisni kërkesën për avokat dhe ta dorëzoni në gjykatë.



Nëse e keni hapur çështjen në gjykatë dhe keni kërkuar avokat më vonë, gjykata do të vendosë në seancën e ardhshme.

Gjykata vendos për kërkesën tuaj për avokat brenda 5 ditëve.

Nëse e keni hapur çështjen në gjykatë dhe keni kërkuar avokat pak më vonë, atëherë gjykata vendos në një nga rradhët që ju shkoni në gjykatë.


Kur gjykata vendos që ju keni të drejtë për një avokat falas, avokati lidhet me ju dhe fillon menjëherë t'ju ndihmojë.



## 6. LISTA E DOKUMENTAVE QË DUHET TË DORËZONI

Dokumentat që duhet të dorëzoni për të marrë ndihmë juridike falas janë:

- Çertifikatë familjare
- Vërtetim papunësie
- Vërtetim që trajtoresh me ndihmë ekonomike
- Vërtetim që merrni pagesë të aftësisë së kufizuar
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që dispononi
- Vërtetim page bruto dhe neto
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore



Nuk është gjithmonë e nevojshme të dorëzoni të gjitha këto dokumente

Për shembull nëse punoni duhet të merrni vërtetim për pagën dhe jo vërtetimin e papunësisë.



## 7. KU MUND TË MERRNI MË SHUMË INFORMACION?

**[www.ndihmajuridike.gov.al](http://www.ndihmajuridike.gov.al)**

Numri jeshil pa pagesë: **08001010**

Facebook: **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas**

Instagram: **@DrejtoriaNdhmesJuridikeFalas**

**[www.juristionline.al](http://www.juristionline.al)**

### **Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore:**

- 1.** Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Tiranë.  
Adresa: Ministria e Drejtësisë, Bulevardi “Zogu I”, Tiranë.
- 2.** Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Gjirokastrë.  
Adresa: Qafa e Pazarit”, brenda ambientit të ish-Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, kati 0, zyra 101.
- 3.** Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Shkodër.  
Adresa: Rruga “Don Bosko”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- 4.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Fier.  
Adresa: Lagjia “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”,  
Këshilli i Qarkut, Kati i 1, Fier.
- 5.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Korçë.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Apelit Korçë.
- 6.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Durrës.  
Adresa: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të  
Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- 7.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Lushnjë.  
Adresa: Lagjja “Kongresi i Lushnjes”, Rr. “Bajram Haxhiu”  
pranë Bashkisë Lushnje.
- 8.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Pogradec.  
Adresa: Pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- 9.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Lezhë.  
Adresa: Lagjja “Skanderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti” pranë  
Bashkisë Lezhë.
- 10.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Shkodër.  
Adresa: Rruga “Don Bosko”, pranë Gjykatës së  
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

- 11.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë.  
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, kati I-rë, pranë Bashkisë Vlorë.
- 12.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Përmet.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.
- 13.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kavajë.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
- 14.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat.  
Adresa: Zyra me 1-ndalesë, Berat.
- 15.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- 16.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
- 17.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pukë.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
- 18.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Mat.  
Adresa: Pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
- 19.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës.  
Adresa: Rruga “Eksod99”, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

- 20.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Dibër.  
Adresa: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
- 21.** Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan.  
Adresa: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



**ORGANIZATA QË OFRON  
SHËRBIME TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS:**

**Në qytetin e Tiranës.**

- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA).  
Adresa: Rr.: “Vaso Pasha”, Nd. 17, Tiranë, Shqipëri.  
Tel: +355 67 500 20 25, E-mail: crca@crca.al

- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL).  
Adresa: Rr. "Vaso Pasha", Pall 12, Shk 1, Ap 1. Tirane-Albania.  
Tel: +355 4 240 933. E-mail: avokatore@albmail.com
- Qendra "ALTRI".  
Adresa: Rruga "Asim Zeneli", Nr. 15, Tiranë.  
E-mail: qendra.altri@gmail.com / info@altri.al
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza.  
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollesha" Nd. 122, H.4, Ap.8, 1023 Tiranë,  
Tel: (04) 22 33 408, E-mail: info@hotlinealbania.org
- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.  
Adresa: Rruga Bogdanëve, Nr.19, Tiranë.  
Tel: +355 4 2269426, E-mail: info@adrf.al
- Shoqata "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët".  
Adresa: Sheshi "Karl Topia", "Trema Engineering", Pallati "127", Tiranë.  
Tel: +355 4 451 0132, E-mail: info@rmsa.al
- Organizata "Refleksione".  
Adresa: Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Tërshana 2, KI, P.O.Box 2412/1, Tiranë. E-mail: info@refleksione.org
- Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.  
Adresa: Blv. Gjergj Fishta, P. 26, Hy. 2, Ap. 5, K.P. 1001, Tiranë.  
Tel: +355 4 2251 475, E-mail: info@acpd.org.al
- Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara,  
Adresa: Tiranë. Tel: +355 4 222 3880, E-mail: office@qshpli.org

- Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”.  
Adresa Rr: Fortuzi, Godina nr. 24, Hyrja nr.4, Apartamenti. nr.4, Tiranë.  
Tel: +355 (4) 222 18 92, E-mail: [contact@differentandequal.org](mailto:contact@differentandequal.org)
- Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”.  
Adresa: Blv "Bajram Curri", Pallatet “Agimi”, Shk.18, Ap.322, Tiranë.  
Tel: + 355 4 2253113, Email: [tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al)

### Në qytetin e Shkodrës.


Qendra e Gruas Hapa të Lehtë, Shkodër.  
Adresa: Shkodër. Tel.: +355 (0) 222 41 316,  
E-mail: [info@hapatelehta.org](mailto:info@hapatelehta.org)



### **INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË, KLINIKAT E LIGJIT.**

1. Fakulteti i Drejtësisë; Adresa: Rr. “Milto Tutulani”, Tiranë.  
Tel: +355 4 22 22 537, E-mail [info@fdut.edu.al](mailto:info@fdut.edu.al)
2. Kolegji Universitar “Wisdom”; Adresa: Rr. “Fuat Toptani”, Tiranë.  
Tel: +355 67 602 2770, E-mail: [info@wisdomuniversity.eu](mailto:info@wisdomuniversity.eu)
3. Universiteti European i Tiranës.  
Adresa: Kompleksi “Xhura”, Rr. “Xhanfize Keko”, Tiranë.  
Cel: +355 68 201 6616, E-mail: [info@uet.edu.al](mailto:info@uet.edu.al)

4. Universiteti “Qirjazi”. Adresa: Rruga “Taulantet”, Kodër-Kamëz.  
Tel: +355 67 200 0874, E-mail: info@qiriazhi.edu.al
5. Universiteti “Bedër”. Adresa: Rruga “Jordan Misja”, Tiranë.  
Tel: +355 4 24 19 222 Email: info@beder.edu.al
6. Universiteti “Mesdhetar”. Adresa: Bul. “Gjergj Fishta 52”, Tiranë.  
Tel +355 68 604 5669.
7. Universiteti “Marin Barleti”. Adresa: Rr. “Frang Bardhi”, Selitë, Tiranë.  
Cel: +355 69 206 7247, E-mail: info@umb.edu.al
8. Universiteti “Luarasi”. Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë.  
Tel: +355 69 602 6900, E-mail: info@luarasi-univ.edu.al
9. Universiteti “Epoka”.  
Adresa: Rruga Tiranë-Rinas, Km. 12, Vorë.  
Tel: +355 4 22 32 086,  
E-mail: info@epoka.edu.al
10. Klinika e Ligjit Shkodër.  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Fakulteti i Drejtësisë.  
Adresa: Godina e Rektoratit, Kati I-rë,  
Sheshi 2 Prilli, Rr.: “Studenti 24”, Shkodër.





Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



*Ky material informues është përgatitur  
në një version të thjeshtuar  
për të siguruar akses më të lehtë  
në informacion mbi ndihmën juridike falas.*

## MATERIAL INFORMUES

# LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI